

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Edhe pulat nga Tajlanda/ 197 tonë mish përmes Kosovës, raporti i KE ngre pikëpyetje për kontrollet
ADRESA	https://www.gazetatema.net/social/edhe-pulat-nga-tajlanda-197-tone-mish-permes-kosoves-raporti-i-ke-ngre-p-i588552
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 13:31:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 14:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4a7c06d99f4b5d0c77875e9e64143567c4440c8615b0ee243f9ad7ad8b650438
TEKSTI	84503ff447964dd7d01840a99ae5edd5159b02efc59ae83cd77eacd2833b3978
PAMJA	7fa98bded052320fd93747840f81ea256367ce452f367cc5d8bb3a51df53c9d1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a65ad9541ffa8d409aa4592314556931373676ff2940c8d9df7658da53815a46
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	37fa8ea76a78e5b04e7fbef6a77a32a9f5044a1541a67ae3d0621621d26aebcc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a65ad9541ffa8d409aa4592314556931373676ff2940c8d9df7658da53815a46>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

 English

Built and Monetized by 

 English

ie "Shkova bashke me Argiten"/ E akuzoi se ka kaluar nga zyra e Agasis, Berisha "zbythet" ndaj ministres Ismaili: ishte deklarate politike!U dergua ne spitalin e Durrresit pa fundit

Edhe pulat nga Tajlanda/ 197 tonë mish përmes Kosovës, raporti i KE ngre pikëpyetje për kontrollet



26 Shtator 2026, 16:30Sociale TEMA



Shqiptarët konsumojnë mish pule nga Tajlanda.

Që prej 3 shtatorit, BE-ja dhe vendi ynë kanë ndaluar importin e disa kategorive të mishit nga Brazili, ndërsa fabrikat e sallamit duket se kanë gjetur një treg të ri furnizimi në Tajlandë.

Që prej vitit 2025, Ministria e Bujqësisë i ka hapur dyert importit të mishit të pulës nga Tajlanda, duke specifikuar se do të lejohen vetëm produktet që vijnë nga stabilimentet të certifikuar për eksport në Bashkimin European.

Por ajo që bie në sy është se i gjithë mishi tajlandez, rreth 197 tonë, rrugën për të mbërritur në vendin tonë e ka gjetur përmes Kosovës, si riekспорт.

Ky treg i ri nuk rezulton gjithmonë pa problematika . Në qershor të këtij viti, Komisioni European, gjatë një auditimi në Tajlandë, evidentoi një sërë mangësish në sistemin e kontrollit të prodhimit të mishit të shpendëve mbi kushtet higjienike.

"Komisioni konstatoi se, në pothuajse të gjitha stabilimentet e vizituara, karkasat me kontaminim fekal dërgoheshin për ripërpunim. Sipas raportit, mënyra e transferimit të këtyre karkasave, në disa raste, paraqiste rrezik serioz për përhapjen e kontaminimit fekal".

Problemet vijonin edhe gjatë procesit të ripërpunimit.

"Karkasat e dyshuara si të papërshtatshme dërgoheshin në një zonë tjetër, ku punonjësit e thertores prisnin pjesët e prekura, i lanin me ujë dhe vendosnin nëse pjesë të mishit ishin të përshtatshme për konsum".

Një tjetër problem serioz i evidentuar në raport lidhet me ndarjen dhe gjurmueshmërinë e produkteve të destinuara për tregun e BE-së nga ato që nuk ishin të destinuara për këtë treg.

"Akoma më rëndë, në një stabiliment u konstatuan produkte prej mishi shpendësh të destinuara për eksport në BE, të cilat ishin prodhuar duke përdorur mish të grirë të siguruar nga një stabiliment që nuk ishte i autorizuar për eksport në Bashkimin European."

Raporti ngre pikëpyetje serioze mbi funksionimin e sistemit të kontrollit dhe certifikimit të mishit të shpendëve që eksportohet nga Tajlanda drejt tregut evropian. Për këtë arsye, autoritetet shqiptare, Ministria e Bujqësisë dhe AKU-ja, duhet të verifikojnë me kujdes originën, gjurmueshmërinë dhe sigurinë e produkteve që hyjnë në Shqipëri.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Demo në Kombinat: Rindërtimi duhet të ecë me ritëm, familjet kanë pritur mjatueshëm

14:30 Sociale

Reshjet e para të borës zbardhin Bjeshkët e Tropojës

14:00 Sociale

Destinacioni sekret: Wizz Air sjell në TIA 150 influencers dhe gazetarë për të zbuluar Shqipërinë

12:53 Sociale

Trinjaket nga Kukësi nisin universitetin bashkë: Zgjedhin Farmacinë për të qenë pranë njëra-tjetrës!

12:10 Sociale / 5 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.